



Npi – 01/71 datë: 07.04.2022

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) nenin, 17 pika (f) dhe (p) si dhe nenin 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087; Si dhe në bazë nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/93 datë: 30.04.2018, për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M “Pastërtia” Sh.a. Njësia në Shtime. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 07.04.2022, Miratoi këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi – 01/93 DATË: 30.04.2018**

#### **I**

**Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 07.04.2022, unanimisht miratoi vendimin për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/93 datë: 30.04.2018, për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M “Pastërtia” Sh.a. Njësia në Shtime.**

#### **II**

**A r s y e t i m:** Shfuqizimi i vendimit bëhet për arsye se mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M. “Pastërtia” Sh.a. Njësia në Shtime, përfundon me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të legjislaturës së kaluar të gjashtë, sipas zgjedhjeve lokale të mbajtura më 22.10.2017.

#### **III**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

#### **IV**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi